

P. nr.23/16

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm,** Gjyqtarja **DIANA SINA,** me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarve N. B. nga Gjakova, G. A. nga fsh. S. K. Gjakovë, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, kundër të akuzuarve D. H. dhe B. H. që të dytë nga fsh. B. K. Gjakovë, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshëm në Gjakovë, PP.nr.518/2015 të datës 18.01.2016, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën **03.04.2017** në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të akuzuarve, po të njëjtën datë morri dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

**1.** I akuzuari **N. B.**, nga i ati A. dhe e ëma H. e gjinisë Gj., i lindur me ... në P., e tani banon në Gjakovë, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar-atë i 3 fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

**2.** I akuzuari **G. A.**, nga i ati H. dhe e ëma H. e gjinisë B., i lindur me... në fshatin S. K. Gjakovë, ku dhe tani banon, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

**3.** I akuzuari **D. H.**, nga i ati M. dhe e ëma F. e gjinisë H., i lindur me... në Gjakovë, e tani me banim në fshatin B. K. Gjakovë, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar-atë i 3 fëmijë, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

**4.** I akuzuari **B. H.**, nga i ati M. dhe e ëma F. e gjinisë H., i lindur me... në Gjakovë, e tani me banim në fshatin B. K. Gjakovë, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, student, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

### I.PJESA NDËSHKUESE

**I akuzuari N. B.**

### Ë s h t ë f a j t o r:

#### Sepse:

I Me datën 29.04.2015 rreth orës 23.30 minuta në Gjakovë, rruga N. Tereza shkojnë në lokalitë "Freskia" pronë e të dëmtuarve, që tu hakmerren për rrahje të akuzuarit R. A. shokut të tyre, e kur shkojnë i sulmojnë fizikisht të dëmtuarit duke i goditur me grushta e shkopinj druri pjesëve të trupit, e pasi që i godasin i akuzuari N. e G. largohen me të shpejtë nga lokali e të vetmuar e lejnë të akuzuarin R. A., ashtu që nga goditjet të dëmtuarve-akuzuarve D. e B. H. nga fsh. B. K. Gjakovë, u shkaktojnë lëndime të lehta trupore të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore të Dr. N. H. dt.11.01.2016.

- me çka në bashkëkryerje ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

**Të akuzuarit D. e B. H. bashkërisht:**

**J a n ë f a j t o r**

**II.** Me datë, kohë e vend të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, deri sa mbetet i vetmuar i dëmtuari-i akuzuari e fillon që të largohet nga lokali, të akuzuarit i vihen nga pas diku 50 metra nga lokali, e kur e zëne e sulmojnë fizikisht dhe e godasin pjesëve trupit me shkopinj bejsbolli, e nga goditjet e rrëzojnë në tokë e ndërhyjnë policia e i ndan, e nga goditjet të dëmtuarit R. A. nga fsh. G. K. Deçan i shkaktojnë lëndime të lehta trupore të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore Dr. N. H. dt.11.01.2016.

- me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4,17,41,49,50,51,52 ,73 dhe nenit 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës, i shqipton:

**Të akuzuarit N. B.**

**DËNIM ME KUSHT**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **5(pesë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Të dëmtuarit-të akuzuarit D. e B. H. nga fsh. B. K. Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohet I akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale në emër të akt ekspertimit mjeko ligjore në shumë prej **10.-Euro**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **30,00 Euro**, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Gjykata në bazë të nenit 4,17,41,49,50,51,52 ,73 dhe nenit 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës, iu shqipton:

**Të akuzuarve D. e B. H.**

**DËNIM ME KUSHT**

Të akuzuarit **D. H.** dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Të akuzuarit **B. H.** dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I dëmtuari-i akuzuari R. A. nga fsh. G. K. Deçan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohen të akuzuarit që të paguajnë shpenzimet procedurale në emër të akt ekspertimit mjeko ligjore në shumë prej **10.-Euro, në mënyrë solidare**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **30,00 Euro, secili veç e veç**, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi

### **PJESA REFUZUESE**

Në baze të nenit 363 pika 1 nën par.1.1 të KPPK-ës, për të akuzuarin **G. A.**

### **REFUZHET AKUZA**

**Kinse:** Me datën 29.04.2015 rreth orës 23.30 minuta në Gjakovë, rruga N.Tereza shkojnë në lokalin “Freskia” pronë e të dëmtuarve, që tu hakmerren për rrahje të akuzuarit R. A. shokut të tyre, e kur shkojnë i sulmojnë fizikisht të dëmtuarit duke i goditur me grushta e shkopinj druri pjesëve të trupit, e pasi që i godasin i akuzuari N. e G. largohen me të shpejtë nga lokali e të vetmuar e lejnë të akuzuarin R. A., ashtu që nga goditjet të dëmtuarve-akuzuarve D. e B. H. nga fsh. B. K. Gjakovë, u shkaktojnë lëndime të lehta trupore të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore të Dr. N. H. dt.11.01.2016.

-me çka do të kishte kryer veprën penale në bashkëkryerje, lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Të dëmtuarit-të akuzuarit D. e B. H. nga fsh. B. K. Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien ne barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritë aktakuzë PP.nr.518/2015 të datës 18.01.2016, kundër të akuzuarve N. B. nga Gjakova, R. A. nga fsh.G. K. Deçani, G. A. nga fsh. S. K. Gjakovë, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, kundër të akuzuarve D. H. dhe B. H. që të dytë nga fsh. B. K. Gjakovë, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës dhe ka propozuar që të akuzuarit të shpallen fajtor, të dënohen sipas Ligjit dhe të obligohen në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Gjykata sipas kërkesës së prokurorit të shtetit PP.nr.518/15 të dt.27.01.2016 ka marr aktvendim P.nr.23/16 me dt.06.01.2017 jashtë shqyrtimit gjyqësor për të cilën ka pushuar procedurën penale kundër të akuzuarit R. A. nga fsh.G. K. Deçan, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, pasi që prokurori i shtetit ka njoftuar gjykatën se në bazë të raportit nr.7474 të dt.02.07.2015 të spitalit rajonal “I. Grezda” në Gjakovë, i akuzuari R. A. ka vdekur gjatë rrjedhës së procedurës penale.

Të akuzuarit N. B., D. H. dhe B. H. në shqyrtimin fillestar të dt.02.03.2017 kanë pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohen, ndërsa i akuzuari G. A. nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet, Gjyqtarja pasi murr mendimin e prokurorit të çështjes në shqyrtimin fillestar murr aktvendim me të cilën

refuzoi pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarve N. B., D. H. dhe B. H., pasi që veprën penale me të cilën akuzohen e kanë kryer në bashkëkryerje me të akuzuarin G. A., në shqyrtimin fillestar të akuzuarit kanë propozuar gjykatës që seanca e radhës të mos caktohet shqyrtimi i dytë gjyqësor, por shqyrtimi kryesor gjyqësor pasi që janë tërhequr nga e drejta për të paraqitur kundërshtim kundër provave të precizuara në aktakuzë dhe kërkesës për hedhjen e aktakuzës, gjykata pasi murr mendimin e prokurorit të çështjes aprovoi propozimin e të akuzuarve dhe caktoi shqyrtimin gjyqësor.

## **PJESA NDËSHKUESE**

I akuzuari N. B. në shqyrtimin gjyqësor lidhur me fajësinë deklaron, se e pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem, edhe njëherë shprehi keqardhje për veprën e kryer, duke premtuar se në të ardhmen nuk do ta përsëris të njëjtën, shton se pas kësaj mosmarrëveshje sipas traditave tona jemi pajtuar në mesë veti dhe i kemi premtuar njeri tjetrit se veprën e tillë nuk do të përsërisim dhe prej atij momenti tani nuk kemi asnjë mosmarrëveshje në mesë veti.

I akuzuari G. A. në shqyrtimin gjyqësor lidhur me fajësinë deklaron, se nuk e pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem.

I akuzuari D. H. në shqyrtimin gjyqësor lidhur me fajësinë deklaron, se e pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem, shton se për herë të parë paraqitem në gjykatë për një vepër të kryer penale, unë jam njeri familjar, njeri i punës, por jam penduar për veprën e kryer, dhe menjëherë pas rastit sipas traditave tona janë takuar burrat dhe ne jemi pajtuar në mesë veti, dhe pasi që N. më ka kërkuar falje për veprimet e veta.

I akuzuari B. H. në shqyrtimin gjyqësor lidhur me fajësinë deklaron, se e pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem, shton se unë jam student dhe herë pas herë ndihmoi në familje në biznesin tonë dhe në bujqësi, për herë të parë paraqitem në gjykatë për një vepër të kryer penale, dhe prej atij momenti ne nuk kemi pasur mosmarrëveshje në mes veti, prandaj i propozoi gjykatë që ti ketë parasysh këto rrethana me rastin e shqiptimit të dënimit.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj para deklarimit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve N. B., D. H. dhe B. H. propozoi që të dëgjohen të akuzuarit D. H. dhe B. H. në rrethanën se ditën kritike i akuzuari G. A. a ka qenë i involvuar në këtë mosmarrëveshje të tyre.

Gjykata pasi murr pëlqimin e të akuzuarve aprovoi propozimin e prokurorit të çështjes që para deklarimit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve N. B., D. dhe B. H. të dëgjohen të akuzuarit D. dhe B. H.

I akuzuari D. H. deklaron, se ditën kritike unë së bashku me vëllain tim B. mosmarrëveshje kemi pasur me N. B. dhe R. A., ndërsa me G. A. fare nuk kam pasur mosmarrëveshje, i njëjti nuk ka ndërhyrë në këtë mosmarrëveshje e as që e kam vërejtur ditën kritike, këtë deklaratë e kam dhënë edhe në Stacionin policor dhe qëndroi pranë asaj deklaratë.

I akuzuari B. H. deklaron, se ditën kritike unë së bashku me vëllain tim D. mosmarrëveshje kemi pasur me N. B. dhe R. A., ndërsa me G. A. fare nuk kam pasur mosmarrëveshje, i njëjti nuk ka ndërhyrë në këtë mosmarrëveshje e as që e kam vërejtur ditën kritike, këtë deklaratë e kam dhënë edhe në Stacionin policor dhe qëndroi pranë asaj deklaratë.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj pasi dëgjoi deklaratat e të akuzuarve D. dhe B. H. lidhur me mos involvimin e të akuzuarit G. A. në këtë mosmarrëveshje, Gjykatës i propozoi që të bëhet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve N. B., D. dhe B. H., ndërsa në mungesë të

provave se i akuzuari G. A. ka kryer veprën penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, tërhiqem nga ndjekja penale në mungesë të provave.

Në shqyrtimin gjyqësor gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari N. B.: Me datën 29.04.2015 rreth orës 23.30 minuta në Gjakovë, rruga N.Tereza shkojnë në lokalin “Freskia” pronë e të dëmtuarve, që tu hakmerren për rrahje të akuzuarit R. A. shokut të tyre, e kur shkojnë i sulmojnë fizikisht të dëmtuarit duke i goditur me grushta e shkopinj druri pjesëve të trupit, e pasi që i godasin i akuzuari N. e G. largohen me të shpejtë nga lokali e të vetmuar e lejnë të akuzuarin R. A., ashtu që nga goditjet të dëmtuarve-akuzuarve D. e B. H. nga fsh.B. K. Gjakovë, u shkaktojnë lëndime të lehta trupore të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore të Dr. N. H. dt.11.01.2016.

Në tërësi u vërtetua se të akuzuarit D. dhe B. H. bashkërisht: Me datë, kohë e vend të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, deri sa mbetet i vetmuar i dëmtuari-akuzuari e fillon që të largohet nga lokali, të akuzuarit i vihen nga pas diku 50 metra nga lokali, e kur e zëne e sulmojnë fizikisht dhe e godasin pjesëve trupit me shkopinj bejsbollit, e nga goditjet e rrëzojnë në tokë e ndërhyjnë policia e i ndan, e nga goditjet të dëmtuarit R. A. nga fsh.G. K. Deçan i shkaktojnë lëndime të lehta trupore të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore Dr. N. H. dt.11.01.2016.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit N. B., D. dhe B. H., të cilët në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjyqëse konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve N. B., D. dhe B. H. formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve N. B., D. dhe B. H. gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPP-së të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: janë njerëz familjar dhe të punës, gjendjen e tyre ekonomike, pranimin e fajësisë, pendimin e tyre, pajtueshmërinë e tyre dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra penale, e sidomos faktin se për herë të parë ndeshen me ligjin, nuk janë recidivista, si rrethana rënduese Gjykata vlerësoi rrethanat në të cilat është kryer vepra, motivet për kryerjen e veprës, kështu që gjykata ka ardhur në përfundim se për të akuzuarin N. B. ti shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej **5(pesë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, për të akuzuarit D. dhe B. H. ti shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve për secilin veç e veç**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nën par.2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1. të KPP-së.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

### **PJESA REFUZUESE**

I akuzuari G. A. në shqyrtimin fillestar dhe në shqyrtimin gjyqësor lidhur me fajësinë deklaroi, se nuk e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet, me arsyetim se fare nuk kam marr pjesë në këtë mosmarrëveshje, unë nuk kam qenë në vendin e ngjarjes.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj pasi dëgjoi deklaratat e të akuzuarve D. dhe B. H. lidhur me mos involvimin e të akuzuarit G. A. në këtë mosmarrëveshje, Gjykatës i propozoi që të bëhet pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarve N. B., D. dhe B. H., ndërsa në mungesë të provave se i akuzuari G. A. ka kryer veprën penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, tërhiqem nga ndjekja penale në mungesë të provave.

Pasi që Prokurori i shtetit Ismet Tofaj është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit G. A. për shkak se do të kryente në bashkëkryerje veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, andaj Gjykata në bazë të nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK-ës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.3 të KPPK-ës.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri në mbështetje të nenit 454 par.1 të KPPK-ës.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.23/16 më datë 03.04.2017.**

**Sekretarja juridike,  
Lamije Kuqi**

**Gj y q t a r j a  
Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimit është e lejuar ankesa, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.